



---

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

# **PËRMBLEDHJE E RAPORTIT**

**Për**  
**Veprimtarinë e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve**  
**1 Janar – 31 Dhjetor 2018**

Mars 2019

**I nderuar zoti Kryetar i Komisionit të Ligjeve,**  
**Të nderuar deputetë, anëtarë të këtij komisioni,**

Ky është raportimi im i dytë vjetor përpara komisionit të ligjeve. Për mua është nder i veçantë ky komunikim me ligjvënësin, por është edhe përgjegjësi. Në emër të KQZ-së më duhet të jap llogari për një vit pune dhe ushtrimi detyrash, më duhet të tregoj se a ia kemi dalë, si ia kemi dalë të zbatojmë ligjin dhe të plotësojmë rekomandimet e Kuvendit, rekomandimet tuaja.

Ky raportim kryhet në një kohë të ngarkuar, për ju me politikë, për KQZ-në me punë. Ndoshta kjo e bën më të vështirë përqendrimin tek raportimi për çështje që nuk janë aktuale, që i përkasin së shkuarës, që nuk kthehen dot mbrapsht.

Ne ngjarjet nuk i kthejmë dot mbrapsht, por mësimet prej tyre mund të nxjerrim, mbi këtë bazë, të metat mund t'i korigjojmë, punën mund t'a përmirësojmë. Për këtë na duhet vlerësimi, gjykimi, këshilla e komisionit të ligjeve, sidomos, për shkak se viti që po përjetojmë është kaq i ngarkuar me politikë e me punë.

Raporti vjetor i vitit 2018, sikurse është miratuar nga KQZ-ja, i është vënë në dispozicion këtij komisioni të nderuar menjëherë pas miratimit.

Administrata e KQZ-së ka përgatitur edhe një përmbledhje të shkurtuar të tij me informacionet dhe statistikat kryesore, e cila gjithashtu është në dispozicionin tuaj, prandaj unë do ju kërkoj leje që në fjalën time të ndalem kryesisht në raportimin tonë lidhur me zbatimin e Rezolutës së Kuvendit të vitit të kaluar për veprimtarinë e KQZ-së.

Viti 2018, ka qenë vit jozgjedhor ndaj, trupa e KQZ dhe të gjithë strukturat e administratës së saj janë angazhuar maksimalisht në realizimin e analizave të thelluara për problematikat e shfaqura në zgjedhjet e kaluara, në mënyrë që të merren masat për t'i minimizuar apo eliminuar në procesin zgjedhor të 2019.

1. Rekomandimi nr.1 i Kuvendit i lë detyrë KQZ-së, bërjen e një analize të vendimmarrjes së KQZ-së gjatë procesit zgjedhor të vitit 2017, duke mbajtur në konsideratë gjetjet e raportit të OSBE-ODIHR-it. Raporti i OSBE-ODIHR është pjesë e pandarë e punës së KQZ-së dhe natyrisht ne i referohemi të gjithë rekomandimeve të tij. Dhe sa i përket pjesës ku raporti i OSBE/ODIHR është shprehur se ***“KQZ-ja pati mospërputhje në qasjen e saj për regjistrimin e kandidatëve dhe vendosjen e masave për shkelje të kuotave të përfaqësimit gjinor në listat e kandidatëve”***, kjo është e lidhur me marrëveshjen politike të 18 majit 2017, dhe KQZ ishte në kushte specifike, ishin rrethana që nuk vareshin nga KQZ.

Përsa i përket trajtimit, regullimit ose plotësimit me akte në kompetencë të KQZ-së për çështjet e shit-blerjes së votës, korrupsionit të administratës zgjedhore, mashtrimit zgjedhor, abuzimet me burimet shtetërore dhe presionet mbi zgjedhësit, **me lejoni të them se**, KQZ nuk ka nxjerrë apo miratuar akte për shit-blerjen e votës, mashtrimin zgjedhor apo korrupsionin e administratës zgjedhore, **por gjatë vitit 2018**, në fokus të punës ka qënë realizimi i sesioneve trajnuese për veprat penale që cënojnë zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve, edhe në zbatim të rekomandimit të Raportit Përfundimtar të OSBE/ODHIR.

Janë realizuar sesione trajnimi&edukimi zgjedhor, në 8 qarqe të vendit ku kanë marrë pjesë target grupe të ndryshme si: studentë, pedagogë, mësues, anëtarë të komunitetit rom, gra, punonjës të bashkive, gazetarë e të tjerë. Në këtë kontekst, u hartuan dhe prodhuan fletë palosje me informacion të plotë për llojet e veprave penale që cënojnë zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve, dhe masën e dënimit për to. U prodhuan dy lloje fletpalosjesh, një për zgjedhësit dhe një për komisionerët.

Zhvillimi i veprimtarive për trajnim & edukim zgjedhor përgjatë vitit 2018, dëshmoi gadishmërinë për bashkëpunim të institucioneve arsimore dhe të organizatave të shoqërisë civile, **Dëshmoi gjithashtu, mungesën e shfaqjes së interesit nga**

**partitë politike** për të orientuar burimet njerëzore, potencialisht komisionerë të nesërm, për të aplikuar/trajnuar/çertifikuar për administrim zgjedhor në periudhë jo zgjedhore.

Ndërsa lidhur me abuzimin e burimeve shtetërore, KQZ ka gati draft-udhëzimin për çeshtjen e financimit të partive politike ku është i përfshirë dhe keqpërdrimi i burimeve shtetërore.

2. Përsa i përket rekomandimit të dytë të Kuvendit, KQZ gjatë vitit 2018 në bashkëpunim të ngushtë me partnerët ndërkombëtarë, OSBE, KiE, NDI, Ambasadën Britanike, UN Eomen, ka zhvilluar ëork-shop-e, tryeza teknike, konferenca lidhur me trajnimin e komisionerëve, edukimin qytetar, financimin e partive politike, keqpërdorimin e burimeve shtetërore etj., të cilat kanë patur si qëllim analizimin e problematikave të hasura gjatë punës, studimin e praktikave më të mira dhe masat që KQZ duhet të ndërmerre për minimizimin apo eliminimin e tyre në zgjedhjet e 2019. Ky bashkëpunim ka sjellë rritjen e kapaciteteve profesionale të trupës dhe administratës së KQZ-së.

3. Hartimi i metodologjisë për kontrollin dhe verifikimin e shpenzimeve të financimeve të partive politike dhe fushatave elektorale, është Rekomandimi i 3-të i Kuvendit. Me kënaqësi mund të deklaroj para jush se, Trupa dhe Administrata e KQZ-së, me mbështetjen e pakushtëzuar të NDI dhe Ambasadës Britanike në Tiranë, gjatë vitit 2018 kanë punuar intensivisht me ekspertët

ndërkombëtare për analizimin e të gjithë aspekteve që kanë të bëjnë me financimin e partive, studimin e praktikave më të mira ndërkombëtare dhe identifikimin e metodologjive të cilat mund të përshtaten në vendin tonë. Janë rishikuar të gjithë aktet dhe udhëzimet e miratuara nga KQZ dhe në fund së shpjeti do të miratohen aktet dhe udhëzimet e reja, të cilat do të zbatohen në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore.

4. Sa i përket, detyrimeve financiare që u kanë lindur subjekteve zgjedhore për shkak të vendimeve me gjobë për shkelje të dispozitave ligjore (Rekomandimi 4), janë mbledhur të gjitha sanksionet, përvec një sanksioni i cili është duke ndjekur procedurat e parashikuar në nenin 511 të Kodit të Procedurës Civile.

5. Ashtu siç edhe Kuvendi i Shqipërisë na la detyrë për vitin që kaloi, KQZ ka analizuar dhe shqyrtuar bazën e të dhënave të administratës zgjedhore, si dhe kemi përpunuar konkluzionet duke e trajtuar çështjen nga këndvështrimi historik i sjelljes politike të subjekteve zgjedhore gjatë proceseve zgjedhore. Nuk do të ndalem në detaje pasi ju e keni tashmë materialin e zgjeruar, por gjykoj se vlen të theksohet fakti që partitë politike i sjellin me vonesë propozimet e tyre për komisionerë dhe i ndryshojnë komisionerët në mënyrë të vazhdueshme. Kjo sjellje e partive politike ndikon;

- në opinionin publik për paanshmërinë, hedh dyshime për pavarësinë e administratës zgjedhore;
- cënon profesionalizmin e komisionerëve (zëvendësimet ndodhin pasi KQZ ka realizuar trajnimin e KZAZ-ve);
- cënon kolegjalitetin e funksionimit të KZAZ-ve, edhe për shkak të mosnjohjes së procedurave nga anëtarët e pa trajnuar;
- cënon njëtrajtshmërinë e procesit, veçanërisht atë të numërimit të votave, shkakton vonesa në nxjerrjen e tabelave të rezultateve, e të tjerë.

Emërimet e komisionerëve të nivelit të III-të (KQV), në tejkalim të skajshëm të afatit ligjor apo të anëtarëve të grupeve të numërimit të votave (GNV), përgjithësisht para fillimit të procesit të numërimit por edhe gjatë procesit të numërimit, sjellje e dëshmuar në të gjitha proceset zgjedhore, **cënon rëndë mirëadministrimin e procesit zgjedhor, fakt i cili reflektohet edhe në raportet e OSBE/ODIHR-it.**

Partitë politike propozojnë kandidatura me eksperiencë zgjedhore kryesisht për nivelin e dytë të administratës zgjedhore, KZAZ-të, ndërsa për nivelin e III-të të administratës zgjedhore (KQV-të, GNV-të), përqindja e kandidaturave me eksperiencë është e

reduktuar. Eksperienca ka dëshmuar se komisionerë me eksperiencë të mëparshme zgjedhore, kanë gabuar në kryerjen e procedurave nga më klasiket.

Duke u vetëmjaftuar me eksperiencën zgjedhore, partitë politike dhe vetë kandidatët e propozuar prej tyre për anëtarë të KZAZ-ve, **tregojnë sjellje neglizhente ndaj trajnimit të KQZ-së**, duke cënuar skemën e trajnimit dhe profesionalizmin e KZAZ-ve.

Kjo sjellje e partive politike duhet të marrë fund, pasi cënon rëndë administrimin e procesit zgjedhor.

6. Si një nga çështjet më sfiduese të punës së KQZ-së do të veçoja zbatimin e ligjit 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”. Nga fillimi i zbatimit të Ligjit për dekriminalizimin në 2015 deri në fund të vitit 2018, KQZ ka trajtuar gjithsej 166 vendime.

- Në vitin 2016 ka marrë 57 vendime nga të cilat 50 janë për verifikim të anëtarëve të këshillave bashkiakë, 4 për deputetë dhe 3 për kryetarë bashkie.
- Në vitin 2017 janë marrë 82 vendime nga të cilat 40 janë për verifikim të deputetëve, 9 për kryetarë bashkie dhe 33 për anëtarë të këshillave bashkiakë.



➤ Në vitin 2018 ka marrë 27 vendime nga të cilat, 8 janë për verifikim në kategorinë deputetë dhe 19 për anëtarët e këshillave bashkiakë.

Gjatë zbatimit të ligjit të dekriminalizimit, KQZ ka hasur problematika të ndryshme gjatë vendimmarrjes, për shkak të parashikimeve jo të plota të situatave në ligjin 138/2015 apo Vendimin e Kuvendit 17/2016.

**Madje për shkak të kësaj mungese janë vërejtur qasje të ndryshme në vendimmarrjet e KQZ-se në raport edhe me institucionin e prokurorisë.**

Natyra e rasteve të cilat kanë sjell trajtime të ndryshme në vendimmarrjet e KQZ-së do veçoja dy prej tyre;

- Mosparashikimi i transferimit të dosjeve/ apo njësimi i procedurës verifikuese të kryera nga disa organe përgjegjëse për të njëjtin subjekt deklarues, për shkak të emërimit dhe/ose zgjidhjes se tij në disa funksione/ pozicione publike.
- Qëndrimet e ndryshme të mbajtura nga KQZ dhe Prokuroria e Përgjithshme në lidhje me trajtimin e rasteve të mosdeklarimit të veprave penale nga subjektet deklaruese, që nuk përfshihen në sferën e ndalimeve të ligjit. Hendeku midis Ligjit dhe Vendimit të Kuvendit në lidhje me rastet e mosdeklarimit të veprave penale nga subjektet deklaruese që nuk përfshihen brenda sferës së ndalimeve dhe/ose periudhës

së ndalimit ka sjellë qasje të ndryshme të zbatimit nga organet kompetente për verifikimin si KQZ dhe Prokuroria e Përgjithshme.

7. Për zbatimin e rekomandimit nr. 7 të Kuvendit, lidhur me bashkëpunimin me Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile për përmirësimin e regjistrave dhe sistemit të adresave, nuk është bërë asgjë. Kemi hasur në indiferencën e Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile.

Të nderuar deputetë,

Kjo është fotografia e vitit që shkoi. Për pyetje dhe sqarime unë dhe stafi i KQZ-së jemi me kënaqësi në dispozicion. Por unë dua t'a shfrytëzoj këtë mundësi për të kërkuar më shumë vëmendje dhe mbështetje nga ana juaj në një çështje themelore.

Përplasja politike, me shumë gjasë, nuk ka për t'a lënë KQZ-në pa e përfshirë në vorbullën e saj, sepse përplasja politike do godasë dhe zgjedhjet lokale, së paku administrimin e tyre.

Nëse ndodh, atëherë Kuvendi duhet t'i japë mbështetje të përforcuar KQZ-së, duhet të mbrojë pavarësinë e tij, duhet t'a inkurajojë në zbatimin me fanatizëm të ligjit.

Që zgjedhjet lokale të zhvillohen me sukses, ato kanë nevojë për një administratë të vendosur, të fortë, serioze e profesionale. Këtë gjë nuk e ka në dorë KQZ-ja, nuk e ka vetëm KQZ-ja. Sidomos Kuvendi mund të bëjë shumë në këtë drejtim.

Që zgjedhjet lokale të zhvillohen me standard, duhet që administrata zgjedhore të jetë e besueshme, jo vetëm për ata që konkurojnë, por në radhë të parë, për ata që votojnë. Edhe për këtë nuk mjafton vetëm KQZ-ja. Kuvendi mund të bëjë shumë edhe në këtë drejtim.

Ju lutem mbajeni në vëmendje këtë shqetësim, sepse mund të ketë nevojë për ndërhyrjen tuaj.

Ju faleminderit!